



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:264805

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05394816

KF.nr.581/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Bersan” Sh.P.K., me numër fiskal të biznesit 601657036 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Xh.K. zyrtar i DK-së, duke vendosur në rigjykim dhe rivendosje sipas aktvendimit K.DH.SH.II.nr.264/22 të datës 18.05.2023 të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, me bazë ligjore anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me 30.01.2024 në prani të avokatit të palës paditëse K.B., e në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Xh.K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Bersan” Sh.P.K me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi nr.01.3.2.2/259 i datës 23.05.2019, i Doganës se Kosovës me seli në Prishtinë, dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 03.07.2018, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, ndaj aktvendimit nr.01.3.2.2/259 të datës 23.05.2018, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Sektorit të Shqyrtimit dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara në emër të detyrimeve të importit të paguar me tepër mbi vlerën e transaksionit.

Paditësi si në padi dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 30.01.2024 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se e paditura me anë të vendimit të atakuar ka shkelur dispozitat ligjore në mënyrë siç është elaboruar si në detaje në padi përkatësisht nenin 33 të KDAK-së lidhur me nenin 123 të UA 11/2009 pasi që paditësi DUD-it kontestues i ka bashkangjitur dokumentet relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit të mallrave të detyruara doganim, përkatësisht pagesën avans në emër të mallit, faturën, transferin e pagesës nga shitësi tek blerësi për pjesën e paguar më tepër në avans se sa vlera finale e faturës, deklaratat eksportuese si dhe dokumentin e datës 01.01.2018 i titulluar shkresë për furnizim e që i ka elementet e kontratës së shitblerjes së mallrave, me të cilin dokument është specifikuar vlera e Rabatit-zbritjes që shitësi i ka lejuar paditësit. Ka shtuar se e paditura nuk ka pranuar Rabatin e lejuar nga eksportuesi për paditësin me arsyetimin se nuk është theksuar ndonjë arsye për këtë Rabat, por nuk ka specifikuar ndonjë dispozitë ligjore në bazë të cilës Rabati do të duhej të kishte një arsyetim specifik. Tutje ke theksuar se Rabati prej 57% siç theksohet në shkresën e datës 01.01.2018 është llogaritur nga çmimi i shitjes me pakicë pastaj edhe kur merren për bazë lirimet nga tatimet për mallrat që eksportohen konsiderojmë se ka qenë çmim real. Në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar ashtu që të anulohet aktvendimin e atakuar dhe të detyrojë të paditurën që ti kthejë paditësit mjetet e paguara më tepër për shkak të ndryshimit të deklaratës doganore në shumë prej 5,628.32 Euro me kamate në shkallë prej 8% nga data 11.04.2018 e deri në kthimin e plotë.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 15.01.2020 e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 30.01.2024 përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës ka deklaruar se pretendimet e paditësit janë të pabazuara për arsye se me rastin e deklarimit të mallit e paditura ka kontrolluar dokumentacionin dhe i është refuzuar kërkesa për lirim – zbritje Rabat e cila në përqindje është shumë e lartë prej 57.50%. Ka shtuar se pretendimi i paditësit se aktvendimi i të paditurës është marrë me shkelje ligjore është në tërësi i pabazuar sepse e paditura nuk i ka ngritur bazën doganore paditësit por vetëm në bazë të dokumentacionit që vet paditësi ka deklaruar edhe ka vazhduar procedurat doganore në metodën e parë të vlerësimit. Tutje ka theksuar se e paditura edhe në aktvendimin kontestues ka sqaruar se dokumentacioni përcjellës i mallit është vlerësuar si i pamjaftueshëm për ti bërë zbritje paditësit për arsye se deklarata eksportuese ka qenë vetëm në faqen e parë, pastaj kontrata e lidhur në mes të shitësit dhe blerësit nuk përmban kushte se pse i është dhënë Rabati (zbritje). Pretendimi paditësit se paditura nuk ka ofruar asnjë provë për vlerën si në DUD kontestues, është

pretendim i pabazuar sepse e paditura i është referuar faturës që vet paditësi e ka dorëzuar me rastin e deklarimit të mallit, faturës nr.1800000137 të datës 30.03.2018. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura gjithashtu nuk ka mundur të konstatoj se paditësi ka paguar mbi vlerë e faturës ka theksuar se është gjithashtu i pabazuar sepse në ato raste konstatohet ndryshimi nga vlera e faturës dhe deklarimi më i ultë atëherë lënda procedohet në procedure penale me kualifikim me shmangie nga tatimi. Në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal me aktvendimin A.nr.1638/19 të datës 15.09.2020 ka marr aktgjykim me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi vendimin kontestues të të paditurës, të cilin paditësi brenda afatit ligjor e ka atakuar në Gjykatën e Apelit.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, e njëjta është transferuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për në Gjykatën Komerciale të Kosovës për shqyrtim të mëtejme në bazë të kompetencës lëndore, dhe ka marrë numrin K.DH.SH.ii.nr.264/22.

Gjykatat Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së dytë, me datë 18.05.2023 ka marr aktvendim me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së parë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në ri procedurë, në shqyrtimin gjyqësor kryesor - publik të datës 30.01.2024, ka administruar provat dhe atë: përgjigja në padi e datës 15.01.2020 nga e paditura Dogana e Kosovës, Aktvendimi nr. 01.3.2.2/259 datës 23.05.2018, fatura 1800000137 e datës 30.03.2018, pagesa bankare për mall e datës 29.03.2018, deklarata doganore në versionin e deklaruar nga paditësi dhe DUD të ndryshuar nga paditura, transferi bankar nga eksportuesi me kthimin e diferencës nga pagesa avans, shkresa private për furnizim të mallit Sonny Bono PE 2018 datës 01.01.2018, CMR, procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, deklarata eksportuese dhe urdhër pagesë për taksa e datës 11.04.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën

Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata gjeti se nuk është kontestuese fakti se paditësi me datë 07.04.2018, ka paraqitur DUD R-7799, për zhdoganim zyrës së brendshme doganore Prizren. Nuk është kontestues as fakti se Dogana e Kosovës, Sektori i pranimit qendror nuk ka pranuar diskonte (lirimim), e paraqitur në dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor duke sjell procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, dhe e ka rivlerësuar DUD-in lëndor, duke mos e pranuar rabatin (zbritjen) e paraqitur në vlerë sipas faturës përcjellëse të mallit. Gjithashtu, jo kontestuese mbasin edhe faktet se paditësi me datë 02.05.2018, ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, sipas të cilës Dogana e Kosovës me datë 23.05.2018, ka nxjerr Aktvendimin kontestues 01.3.2.2/259, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 03.07.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna te pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse nuk është pranuar zbritja-rabati, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar si dhe nuk konteston asnjë dokumentacion përcjellës, dhe nuk është dhënë asnjë provë për tu dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit e cila është me zbritje/rabat, për të dëshmuar konstatimin e dhënë se vlerës së mallit të deklaruar për zhdoganim nuk duhet t'i pranohet zbritja-rabati. Gjykata vlerëson se vendimi kontestues, nuk përmban informata të mjaftueshme me të cilën pala e paditur do të mund të kundërshtonte vlerën e paguar përmes faturës me zbritje / rabat, pasi që paditësi deklaratave doganore kontestuese i ka bashkangjitur faturën për mallin lëndor në të cilën paraqitet edhe zbritja-rabati, urdhër pagesën ndërkombëtare si dhe dokumentet tjera përcjellëse si deklaratën eksportuese, CMR, ndërsa vendimi kontestuese nuk përmban arsyetim konkret mirëpo vetëm një përmbledhje gjenerale dhe pa mbështetje ligjore.

Për të argumentuar të gjeturat, Gjykata i referohet nenit 123 paragrafit (a) të UA 11/2009 për zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcizave me të cilin decidivisht përcaktohet se cilat dokumente duhet bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje të lirë të mallit *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete. Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Dogana e Kosovës ka analizuar me kujdes dokumentacionin e paditësit, dhe ka ardhur në përfundim se paditësi nuk e ka paraqitur dokumentacionin e duhur që ti pranohet zbritja (rabati), që i është dhënë për mallin kontestues, ngase subjekti ka prezantuar Deklaratën eksportuese vetën në faqen e parë po ashtu kontrata e lidhur në mes të shitësit dhe blerësit nuk i përmban kushtet se pse i është dhënë rabati, po ashtu transferi bankar nuk e përmban numrin e faturës ose pro faturës, andaj e paditura nuk mund të marr për bazë zbritjen e paraqitur në dokumentacionin përcjellës të mallit, gjithnjë duke e pasur parasysh edhe faktin se është praktikë tregtare që për çdo zbritje ti jepen arsyet përkatëse dhe bindëse, në atë mënyrë që të vërtetohet tek autoritetet doganore dhe tatimore që malli në faje nuk është duke u nën vlerësuar dhe detyrimet doganore janë duke e paguar në vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata konstaton se në vendimin e ankimuar, e paditura nuk ofroi një analizë të detajuar të fakteve konform dispozitave ligjore. Të njëjtit i mungon një arsyetim i plotë dhe i bazuar në lidhje me refuzimin e deklaratës së paditësit për vlerën e mallrave të deklaruara në fature, duke përfshirë zbritjet/rabatet, dhe transaksionin bankar që korrespondon me këtë fature, bazuar në metodën e parë të vlerësimit. Kjo pavarësisht se paditësi kishte paraqitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor për të vërtetuar vlerën doganore të mallrave të importuara, siç përcaktohet në neni 33, paragrafi 1 të Kodit Doganor, dhe asnjë arsyetim nuk u dha për mos vlerësimin e deklaratës së eksportit, marrëveshjes së bashkangjitur, rabatit të përcaktuar në faturë dhe pagesave të avancit dhe kthimit të pjesës së paguar më shumë.

Gjykata ka shqyrtuar vendimin kontestuese dhe pretendimet e paditësit lidhur me mospranimin e zbritjeve-rabatit, duke konstatuar se paditësi, ka provuar që me prova bindëse të dëshmoj para Doganës që në kuptim të dokumenteve të prezantuara si fatura, urdhërpagesa ndërkombëtare, deklarata eksportuese dhe CMR, ta krijoj besimin tek Dogana në provat e prezantuara, andaj arsyetimi i të paditurës në aktvendimin kontestues se paditësi nuk ka arritur

të dëshmoj para doganës me dokumentacion të besueshëm zbritjen-rabatin nuk qëndron pasi që e paditura fare nuk ka shqyrtuar faturën në raport me transaksionin bankar të pagesës dhe atë për kthimin e diferencës e të cilat e dëshmojnë harmonizimin e vlerës së faturës me shumën e paguar, si dhe deklaratën eksportuese e cila përkundër thënieve të të paditurës se është paraqitur vetëm në faqen e parë, është e rregullt, pasi që e njëjta është lëshuar në një faqe e që konstatohet nga rubrika 3 e të njëjtës e titulluar “Formulari 1/1”

Sipas vlerësimit të Gjykatës, Fatura lëndore përfshin rabatin, po ashtu nga transaksioni bankar konstatohet se pagesa është bërë në avans dhe se pretendimi i të paditurës se të njëjtës i mungon numri i faturës, gjykata e konsideron si të pabazuar për faktin se transaksioni për avans është realizuar me datë 29.03.2018 në vlerë prej 14,700.00 euro, ndërsa fatura është lëshuar ditën vijuese, respektivisht me datë 30.03.2018, në vlerë prej 13.959,89 euro, ndërsa kthimi i diferencës së avansit të paguar ka pasuar me transaksionin e datës 17.04.2018 në shumë prej 740.11 euro dhe po ashtu paditësi ka bashkangjitur marrëveshjen mes shitësit dhe paditësit sipas të cilës palët janë dakorduar në rabat prej 57.50 %. Se paditësi DUD-at e mëhershëm i ka paraqitur pa lirim(rabat), gjykata e gjen të pabazuar, sepse nga faturat e bashkangjitura DUD-ave të cekur, rezulton se për të njëjtat nuk ka gëzuar rabat e as nuk ka parashtruar kontratë, ndërsa për DUD-in lëndor vërtetohet se marrëveshjen palët e kanë nënshkruar me 01.01.2018.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet te konstatoj këto pretendime dhe argumente te paditësit dhe te deklarohet lidhur me provat e administruara përkatësisht, faturat e mallit lëndor, dokumentet e disponueshme për vlerësimin e mallit, transaksionin bankar, deklaratën eksportuese dhe CMR. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se paditura nuk ka vlerësuar dokumentet si më lartë në raport me pretendimet e paditësit për të konstatuar se faturat, dhe dokumentet përcjellëse, përse nuk janë marr për bazë dhe nuk i kane pranuar si valide, andaj Gjykata vlerëson se aktvendimi-akti administrativ duhet te përmban një përmbledhje te konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjate procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti administrativ ashtu siç parashihet me nenin 47 të ligjit të procedurës së përgjithshme administrative 05/L-031.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet lidhur me provat e paraqitura nga paditësi dhe të administruara nga Gjykata e të

cilat u përmenden më lartë. Po ashtu, gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të shqyrtoj pretendimet e paditësit se a ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, pastaj të verifikohet vlera e paguar e faturave me zbritje / rabat për mallrat e importuara sipas transaksioneve bankare dhe nëse ajo harmonizohet me vlerën e deklaruar, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë. Me referim edhe në nenin 123 par.1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave, me të cilin përcaktohet se “ Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*, gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të gabuar kur nuk e ka pranuar rabatin me arsyetim se nuk ka dëshmuar arsyen se pse i është dhënë rabati.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*.

Vërejtjet e gjykatës janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi gjykata e mori konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.C, 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 43 parag, 2 të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.581/23, datë 20.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.